

KUSHTET DHE AFATET

10 VJET GARANCI "NO BURN IN" PËR TELEVIZORËT SAMSUNG

1. Ky promovion vlen për pajisjet e blera në periudhën nga data 02.07.2020 deri në 16.08.2020 dhe kjo vetëm për blerjen e televizorëve të rinj,* të cilat shprehen në mënyrë të qartë në nenin 9 të këtyre kushteve.

*Si pajisje "të reja" konsiderohen edhe pajisjet e papërdorura të ekspozimit dhe pajisjet në shitje.

2. Garancia 10-vjeçare përfitohet duke dërguar informacionin vijues në adresën e emailit ce.promotion@samsung.com brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të faturës: emri, mbiemri, adresa e emailit, adresa e shtëpisë (për marrjen e garancisë), fatura e skanuar nga pika e shitjes, modeli dhe numri i serisë së pajisjes.

Numri i telefonit për mbështetjen ndaj klientit në bazë të çmimit të thirrjes lokale për rrjetin fiks dhe celular: 045 620 202

3. Për të fituar të drejtën për garanci 10 vjeçare "No Burn in", pajisja me të cilën lidhet garancia duhet të jetë regjistruar online (siç u tha edhe më lart sipas pikës 2.) jo më vonë 30 ditë nga data e lëshimit të faturës së blerjes së kësaj pajisje.

4. Pas regjistrimit, konsumatorit do t'i dërgohet nëpërmjet postës elektronike ose nëpërmjet postës në adresën e banesës (sipas zgjedhjes së vetë konsumatorit), një njoftim mbi regjistrimin dhe fleta e Garancisë 10 vjeçare "No Burn in" me numrin serial të pajisjes së regjistruar.

5. Fletëgarancia për garanci dhjetëvjeçare dhe fatura për blerjen e pajisjes me të cilën lidhet garancia, është e nevojshme të ruhet gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së kësaj garancie.

6. Garancia 10 vjeçare, e cila është objekt i këtij promovioni, nuk është e transferueshme tek një pajisje tjetër Samsung, pra lidhet ekskluzivisht me pajisjen që është regjistruar online në mënyrën e përcaktuar

sipas këtyre Kushteve.

7.Ky promocion është në dispozicion vetëm për klientët fundorë – konsumatorë (individë) dhe nuk lidhet me veprimtari, shoqëri tregtare ose persona të tjerë juridikë që i marrin këto pajisje për rishitje ose përdorim tregtar.

8.Me këtë regjistrim të pajisjes së tij me garanci “No Burn in” 10 vjeçare, klienti deklaron shprehimisht që bie dakord me këto Kushte.

“Është e nevojshme që pajisja të regjistrohet online brenda 30 ditëve nga data e blerjes e cilësuar në faturë”.

9. LISTA E MODELEVE QË JANË OBJEKT I PROMOCIONIT

Model
QE85Q95TATXXH
QE75Q95TATXXH
QE65Q95TATXXH
QE55Q95TATXXH
QE85Q80TATXXH
QE75Q80TATXXH
QE65Q80TATXXH
QE55Q80TATXXH
QE49Q80TATXXH
QE75Q75TATXXH
QE65Q75TATXXH
QE55Q75TATXXH
QE85Q70TATXXH
QE75Q70TATXXH
QE65Q70TATXXH
QE55Q70TATXXH
QE75Q65TAUXXH
QE65Q65TAUXXH
QE55Q65TAUXXH
QE50Q65TAUXXH
QE43Q65TAUXXH

QE85Q60TAUXXH
QE75Q60TAUXXH
QE65Q60TAUXXH
QE58Q60TAUXXH
QE55Q60TAUXXH
QE50Q60TAUXXH
QE43Q60TAUXXH
QE75LS03TAUXXH
QE65LS03TAUXXH
QE55LS03TAUXXH
QE50LS03TAUXXH
QE43LS03TAUXXH
QE32LS03TBKXXH
QE55LS01TAUXXH
QE49LS01TAUXXH
QE43LS01TAUXXH
QE55LS01TBUXXH
QE49LS01TBUXXH
QE43LS01TBUXXH
QE43LS05TAUXXH
QE43LS03RAUXXH
QE49LS03RAUXXH
QE55LS03RAUXXH
QE65LS03RAUXXH
QE43Q60RATXXH
QE49Q60RATXXH
QE49Q65RATXXH
QE55Q60RATXXH
QE55Q65RATXXH
QE55Q70RATXXH
QE55Q80RATXXH
QE55Q85RATXXH
QE55Q90RATXXH
QE65Q60RATXXH
QE65Q65RATXXH
QE65Q70RATXXH
QE65Q80RATXXH
QE65Q85RATXXH
QE65Q90RATXXH
QE75Q60RATXXH

QE75Q70RATXXH
QE75Q85RATXXH
QE75Q90RATXXH
QE82Q60RATXXH
QE82Q70RATXXH

DEKLARATE PËLQIMI (Shqipëri)

Duke klikuar në butonin “Regjistrohu”, i jap shoqërisë tregtare Samsung Electronics Austria GmbH, degës së saj lokale dhe degëve të tyre, miratimin tim të shprehur që të dhënat e mia personale të mësipërme të grumbullohen nëpërmjet kësaj platforme elektronike dhe të përdoren prej tyre me qëllim të regjistrimit të pajisjes time të blerë, të ofrimit të shërbimit të servisit të pajisjeve gjatë periudhës së garancisë 10 vjeçare dhe të kontaktimit në lidhje me sa më lart. Jam njohur me Politikën e privatësisë së Samsung që është e disponueshme në: <https://www.samsung.com/al/privacy/> dhe jap pëlqimin tim të shprehur që të dhënat e mia personale të përdoren në përputhje me të.

Gjithashtu jam në dijeni se:

- kontrollues i të dhënave personale është Samsung Electronics Austria GmbH
- dhënia e pëlqimit tim për grumbullimin e të dhënave personale në kuadrin e promovimit është vullnetar dhe në rast se vendos të mos ndaj të dhënat e mia personale me Samsungun, nuk do të fitojë të drejtën për garanci 10-vjeçare “No Burn in”,
- menaxheri i mësipërm i koleksionit të të dhënave personale me kërkesën time do të plotësojë, ndryshojë ose fshijë të dhënat e mia personale në qoftë se ato janë të paplota, ta pasakta ose të papërditësuara dhe në qoftë se përpunimi i tyre nuk është në përputhje me ligjin,
- në çdo moment mund të tërheq pëlqimin tim për mbledhjen ose për përpunimin e të dhënave të mia personale duke kontaktuar Samsung Electronics Austria GmbH, nëpërmjet të dhënave në faqen e internetit: <https://www.samsung.com/al/privacy/>
- baza ligjore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të mia personale është ushtrimi i të drejtës për 10 vjet garanci “No Burn in”,

- të dhënat e mia personale do të ruhen për kohëzgjatjen prej 10 vjetësh, pra deri në skadimin e garancisë 10 vjeçare,
- akseson të dhënat e mia personale me qëllim të përpunimit të të dhënave personale dhe dërgim dokumenti për garancinë, krahas Samsung Electronics Austria GmbH
- në qoftë se konstatoj se në të dhënat e mia personale është ndërhyrë në mënyrë të paligjshme, kam të drejtë në çdo moment të paraqes ankesë pranë autoritetit për mbrojtjen e të dhënave personale.